



Numër: 01/402
Datë: 21.06.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohen të gjitha Institucionet e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (IAAP) të cilat kanë aplikuar për proces të akreditimit/validimit dhe riakreditimit/rivalidimit para datës së marrjes së këtij vendimi si dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (IAAP) që me rastin e aplikimit për akreditim/validim dhe riakreditim/rivalidim të plotësojnë standardet minimale të infrastruktures së nevojshme për personat me aftësi të kufizuara përfshirë por pa u kufizuar në: Pjerrinën me pjerrtësi deri në 6 përqind, dera me gjërësi 1.10 metër dhe me kalueshmëri pa prag, ashensori si dhe tualetet.
2. Institucionet si në paragrafin 1 të këtij vendimi obligohen të plotësojnë kriteret si më poshtë:
 - 2.1. Institucioni të ketë staf përgjegjës të trajnuar për sigurin dhe shëndetin në punë;
 - 2.2. Institucioni duhet të siguroj kushte mikroklimatike sipas standardeve të Sigurisë dhe Shëndetit në punë (ndriçim, lagështia, zhurmë, nxehtësia, ftohtë, pluhurit, etj);
 - 2.3. Institucioni duhet të siguroj Pajisjet Përsonele Mbrojtëse të profesionit/programit dhe që duhet të shfrytëzohen gjatë pjesës praktike nga kandidatët;
 - 2.4. Institucioni duhet të i siguroj udhëzimet e përgjithshme të vendosura në objekt për Siguri dhe Shëndet në Punë, mbrojtje nga zjarri dhe numrat emergjent;
 - 2.5. Institucioni duhet të siguroj udhëzimet në formë të shkruar për pajisjet e punës praktike që shfrytëzohen;
 - 2.6. Institucioni duhet të siguroj kandidatëve para fillimit të praktikës, udhëzimet për rreziqet në formë të shkruar;
 - 2.7. Institucioni duhet të siguroj shenjezim;

- 2.8. Institucioni duhet të siguroj planin e daljes emergjente, si dhe planin për evakuim dhe shpëtim;
- 2.9. Institucioni duhet të siguroj aparatet/ fikse kundër zjarrit;
- 2.10. Institucioni duhet të siguroj ndihmën e parë dhe staf të certifikuar për dhënien e ndihmës së parë;
- 2.11. Institucioni duhet të siguroj se vendi i punës praktike duhet të jetë gjithmonë i mirëmbajtur;
- 2.12. Institucioni duhet të siguroj se pajisjet e punës praktike janë në rregull dhe të mirëmbajtura.
3. Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP) të cilat kanë aplikuar për proces të akreditimit/validimit dhe riakreditimit/rivalidimit para datës së marrjes së këtij vendimi obligohen të plotësojnë kriteret si më lartë në afat kohor 3 deri në 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Obligohen të gjitha palët në procedurë në zbatim të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së lidhur me respektimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuar, bazuar në nenin 10 paragrafi 1 pika 1.6 si dhe me qëllim të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 1 pika 1.9 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, ku si kriter për akreditim Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional duhet të plotësojnë edhe politikat dhe procedura të përshtatshme për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta si dhe IAAP me rastin e aplikimit duhet të ofrojnë dëshmi se vlerësimi i nxënësve/kandidatëve duhet të bëhet në kushte të sigurta dhe mjedisë të shëndosh, Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

Të gjitha IAAP-ve në proces të akreditimit/riakreditimit
Arkivit të AKK-së.

Valmira Sejdiu
Nënkryetare e KD të AKK-së

